

**VENDIM**  
**Nr. 537, datë 22.9.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOVE TË PËRLLOGARITURA PËR PYLLËZIM**  
**KOMPENSUES, NË RASTET E NDRYSHIMIT TË DESTINACIONIT TË FONDIT**  
**PYJOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subjektet përfituese, për të cilat është miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor kombëtar, paguajnë paraprakisht kostot e përllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor, të lejuara nga ligji.

2. Për qëllime të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Ndryshim destinacioni”, tjetërsimi i kores së tokës pyjore.  
b) “Kosto të përllogaritura”, shuma e të gjitha kostove materiale dhe kostove të sasive të punës së gjallë, duke përfshirë kostot për mirëmbajtjen dhe shërbimet kulturore të nevojshme, për të realizuar pyllëzimin e detyrueshëm të sipërfaqeve pyjore, të cilave u ndryshon destinacioni i përdorimit, në saje të një aktiviteti të miratuar paraprakisht dhe të lejuar nga ligji për pyjet.

c) “Lloje pyjore frutore”, drurët ose shkurret që formojnë masive pyjore (grumbuj) në gjendje natyrore (të egër), të tilla si gështenja, arra, lajthia etj.

ç) “Shërbime kulturore”, shërbime të cilat kryhen në objektet e pyllëzuara artificialisht, të tilla si zëvendësimi i fidanëve të tharë, ujitja, prashitja, plehërimi dhe hijëzimi i fidanëve, për një periudhë kohore jo më pak se 3 (tre) vjet, duke përfshirë edhe mbrojtjen e objektit.

d) “Rehabilitim”, tërësia e masave që merren për rigjenerimin dhe kthimin në gjendjen natyrore të njëjtë ose të përafërt me atë të sipërfaqes pyjore të cenuar për shkak të ndryshimit të destinacionit.

3. Përllogaritja e kostove për sipërfaqet zëvendësuese ose kompensuese të rehabilitimit të fondit pyjor bëhet mbi bazën e:

a) trefshit të sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi trugishte dhe cungishte;

b) barazimit me sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi shkurre, si dhe për sipërfaqet me bimësi pyjore.

4. Kostot e përllogaritura për pyllëzimin kompensues për 1 ha (hektarë) janë, si më poshtë vijon:

a) 229 220 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e njëzet) lekë, për skemën e pyllëzimit 2 x 2;

b) 163 632 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë, për skemën e pyllëzimit 3 x 2;

c) 119 780 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, për skemën e pyllëzimit 3 x 3;

ç) 100 686 (njëqind mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, për skemën e pyllëzimit 4 x 3;

d) 83 655 (tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për skemën e pyllëzimit 4 x 4;

dh) 107 160 (njëqind e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për skemën e pyllëzimit 5 x 5 m (për llojet pyjore frutore);

e) 85 990 (tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë, për skemën e pyllëzimit 6 x 6 (për llojet pyjore frutore).

5. Kostove sipas pikës 4, të këtij vendimi, u shtohen rast pas rasti edhe:
- a) kostot e blerjes së fidanëve dhe të transportit të tyre, që u referohen vlerave të tregut në momentin e blerjes;
  - b) kostot e hartimit të projektit në masën 10% të vlerës së projektit, por jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
  - c) kostot e drejtuesit teknik të projektit në masën 10% të vlerës së projektit, por jo më pak se 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.
  - ç) kostot e mbrojtjes së objektit.
6. Ngarkohen bashkitë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
DHE MINISTËR PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE  
**Arben Ahmetaj**